



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3298/6 prot.

Pogradec, më 25.08.2026

VENDIM

NR 101, DATË 24.08.2026

PËR

“MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATAVE TË QIRASË PËR AMBIENTE ARSIMORE NË BASHKINË POGRADEC PËR VITIN SHKOLLOR 2026-2027”

Në mbështetje të të pikës 2 të nenit 8, shkronjës "a", dhe "c", të nënpikës 1.2 të nenit 9, në pikën 12 të nenit 23, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 21, 22, nenit 28, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, në nenin 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", vendimit nr. 621, date 22.10.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj", vendimi nr. 659, datë 03.11.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021- 2026", në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec nr.77, datë 28.08.2025, si dhe mbështetur tek Relacionet shpjeguese të Qendrës Arsimore dhe Kërkesat e Administratorëve të Njësive Administrative,

**KËSHILLI I BASHKISË
VENDOSI:**

1. Miratimin e rinovimit të kontratave të qirasë për ambiente arsimore publike në Bashkinë Pogradec, të cilat do të shërbejnë për zhvillimin e procesit mësimor për vitin shkollor 2026-2027.
2. Rinovimi i kontratave sipas pikës një të këtij vendimi, hyn në fuqi më datë 01.09.2026, që korrespondon me fillimin e Vitit të Ri shkollor 2026-2027 dhe do të zgjasë deri në dt. 01.07.2027.



3. Vlerat e kontratave dhe Kushtet e tjera të tyre mbeten të pandryshuara. Vlerat e qerasë mujore për secilën Njësi Administrative janë si më poshtë:

3.1 **Fshati Selcë e Poshtme Njësia Administrative Proptisht, Bashkia Pogradec,** Rinovimin e kontratës së qirasë për ambientin që shërben si shkollë, me vlerë 8,000 (tetë mijë) lekë në muaj, për periudhën Shtator 2026 - Korrik 2027.

3.2 **Fshati Buzaishtë, Njësia Administrative Velçan, Bashkia Pogradec:** Rinovimin e kontratës së qirasë për ambientin që shërben si kopsht me vlerë 6,000 (gjashtë mijë) lekë në muaj, për periudhën Shtator 2026 - Korrik 2027.

4. Për zbatimin e vendimit, ngarkohet Qendra Arsimore pranë Bashkisë Pogradec.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT

Miranda OLLDASHI



1.Miratuar me 16 **vota**

2.Vota Pro 16

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 24.08.2026